



KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

Nr. Protokolit: 400-01/27657

Data: 08.04.2024

Për: Anëtarët të Kuvendit të Komunës së Pejës

Të nderuar anëtar/e.

Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1, nenit 44, paragrafi 44.1, i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 28, paragrafi 1, nenit 32, paragrafi 1, i Statutit nr. 01-2020 të Komunës së Pejës dhe në bazë të nenit 11, paragrafi 1.3, nenit 15, paragrafi 1, i Rregullorës nr.02-2021 për Punën e Kuvendit të Komunës së Pejës, më kërkesë të Kryetarit të Komunës së Pejës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, ju:

THËRRET

Të merrni pjesë në mbledhjen e I të jashtëzakonshme për vitin 2024, të Kuvendit të Komunës së Pejës. Mbledhja do të mbahet me dt. 16.04.2024 (Marte), ora: 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës së Pejës.

Vërejtje: Kuvendi i Komunës mbanë të drejtën për ta aplikuar nenin 45. paragrafin 3. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nëse kjo gjë shihet e nevojshme.

RENDI I DITËS

1. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për rialokim dhe transferin e mjeteve buxhetore.



KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

Adresa: Rr. Hasan Prishtina

Tel: 03820043433



SKUPŠTINA OPŠTINE PEĆ

Br. Protokola: 400-01/27657

Datum: 08.04.2024. godine

Za: Članove Skupštine Opštine Peć

Poštovani članovi/članice,

Na osnovu člana 43, stav 43.1. Zakona o Lokalnoj Samoupravi, člana 44, stav 44.1, i Zakona o Lokalnoj Samoupravi, člana 28, stav 1, člana 32, stav 1, Statuta br. 01-2020 Opštine Peć i na osnovu člana 11, stav 1.3, člana 15, stav 1, Pravilnika br. 02-2021 o Radu Skupštine Opštine, na zahtev Gradonačelnika Opštine Peć, Predsedavajući Skupštine vas:

POZIVA

Da učestvujete na I vanrednoj redovnoj sednici Skupštine Opštine Peć za 2024. Godinu. Sednica će se održati dana 16.04.2024 (utorak), u 10:00 časova, u sali Skupštine Opštine Peć.

Napomena: Komitet za Politiku i Finansije zadržava pravo primene člana 45 stav 3 Zakona o Lokalnoj Samoupravi, ako se to smatra potrebnim.

DNEVNI RED

1. Razmatranje i usvajanje zahteva za preusmeravanje budžetskih sredstava.



KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

Adresa: Rr. Hasan Prishtina

Tel: 03820043433



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS
MUNICIPALITY OF PEJA
OPŠTINA PEČ



ZYRA E KRYETARIT
MAYOR OFFICE
URED PRECEDNIKA

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr.03/L-40 të datës 20 Shkurt 2008 dhe nenit 52 të Statutit të Komunës së Pejës 01/2020 me numër protokollit I.nr. 01-016/01-413431 i datës 30 shtator 2020, Kryetari i Komunës, z. Gazmend Muhaxheri, më 08.04.2024, merr këtë:

K o n k l u z i o n

I Propozohet Kuvendit Komunal në Pejë për thirrjen e seancës të jashtëzakonshme për shqyrtim dhe aprovim për rialokim dhe transfer të mjeteve financiare sipas propozimit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.

Për implementimin e këtij Konkluzioni do të kujdeset Drejtoratit për Buxhet dhe Financa.

Konkluzioni dërgohet:

- Kryesuesit të Kuvendit Komunal në Pejë,
- Drejtoratit për Buxhet dhe Financa,
- Anëtarëve të Asamblesë Komunale dhe
- Arhives

I.nr. 400 01127657 / 2024
Pejë, 08.04.2024

KOMUNA E PEJËS



Gazmend Muhaxheri
Kryetar i Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

DATË/A	8 Prill 2024
REFERENCE	
PËR/ZA/TO	Gazmend Muhaxheri Kryetar i Komunës Komuna Pejë
CC	
PËRMES/PREKO/THROUGH	
NGA/OD/FROM	Hajrije Haxhijaj Zyrtare Kryesore Financiare Komuna Pejë
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	Kërkesë për rialokim dhe transfer të mjeteve

I nderuari z. Kryetar,

Po ju drejtohem me kërkesë për transfer të mjeteve buxhetore, kjo kërkesë ka rrjedhur si pasojë e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore në shumë prej 2,338,675.17€. Departamenti i Thesarit i Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve në tremujorin e fundit të vitit 2023, e ka debituar llogarinë e komunës së Pejës në emër të vendimeve gjyqësore. Edhe pse për nga natyra e shpenzimeve vendimet gjyqësore i takojnë kategorisë së pagave dhe shtesave (të cilat kanë rrjedhur si pasojë e zbatimit të kontratës kolektive) pagesa e mjeteve është bërë nga projektet kapitale të aprovuara me Ligjin për Ndarjet Buxhetore, për të cilat komuna e Pejës ka kontrata të nënshkruara me operatorët ekonomik.

Prandaj për shkak të situatës së krijuar mungesës së fondeve në projektet e caktuara kapitale dhe për të mundësuar sigurimin e mjeteve për implementimin e projekteve, në duke u bazuar në Ligjin 03/L-048 nëni 30 paragrafi 1 dhe 2 si dhe Ligjit 08/L-260 nëni 15 mbi ndarjet buxhetore për vitin 2024, i rekomandojmë kuvendit komunal që të aprovojë rialokimin dhe transferin në shumë prej 1,270,356.30 Euro.

- Rekomandimi është që nga drejtoria e Shërbimeve Publike shumen prej 722,446.53 e cila duhet të rialokohet në të njëjtin program në projektet e vitit 2023 dhe 2024, dhe
- Shuma prej 113,695.00 rialokohet brenda programit të Arsimit, ndërsa

- Shuma prej 454,274.77€ te bëhet transfer i mjeteve në programe tjera te paraqitura si me poshtë:

Nga Grandi qeveritar fondi burimor (10)

Rialokim nga projektet

- Kod projekti 54632 “Asfaltimi i Rruges Sejnove – Gjore” shuma prej 200,000.00€
- Kod projekti 54637 “Ndërtimi i Deponisë së mbeturinave në Sferkë” shuma prej 93,175.53€
- Kod projekti 54642 “Regullimi i Shetitores prej Urës së Novosellës - Mulliri Bërdynajve” shuma prej 100,000.00€
- Kod projekti 54653 “Blerja dhe montimi i Ashensorëve për objektet banesore komunale në Qendër, Fidanishte, Karagac dhe lagjen Haxhi Zeka” në shumë prej 150,000.00€
- Kod projekti 54664 “Ndërtimi i impiantit në Jabllanicë të Leshanit” në shumë prej 179,271.00€

Shuma e mjeteve për rialokim është 702,446.53 Euro dhe këto mjete do të rialokohen në njëjtin program Shërbime publike - infrastrukture rrugore 18019 sipas rënditjes në vijim:

- Në projektin 52670 “Ndërtimi i rrugëve ne Novoselle, Jabllanice e Madhe, Jabllanice e Vogel dhe Radac” shuma prej 20,000.€
- Në projektin 52671 “Ndërtimi i rrugëve në Kosuriq, Rashiç, Baran, Baran i Epërm, Kotradiq, Turjak, Llugagji dhe Glllogjan” shuma prej 20,000€
- Në projektin 52672 “Ndërtimi i rrugëve në Kamenice, Babiq, Pishtan, Millovanc, Poqest dhe Vragoc” ne shume prej 20,000.€
- Në projektin 52673 “Ndertimi i rrugëve ne Nabergjan,Trestenik,Lutogllave ,Ruhot dhe Llabjan” shuma prej 20,000.€
- Ne projkein 52674 “ Ndertimi i rrugeve Raushi, Loxhe, Graboc dhe Llozhan” shuma prej 20,000. €
- Në projektin 54837 “Ndertimi dhe asfaltimi i rrugëve ne fshatrat; Kamenice, Qallapek, Zillopek, Kryshec dhe Turjake” shuma prej 20,000.€
- Në projektin 54849 “Ndertimi dhe asfaltimi i rrugëve në fshatrat; Zahaq, Qyshk, Katundi i Ri, Leshan, Kliqin, Ozdrim dhe Dubove” shuma prej 50,000.€
- Në projektin 54936 “Ndërtimi i rrugëve ne lagjet Karagaq, Kapeshnice dhe Puhove” shuma prej 25,000.€
- Në projektin 54937 “Ndërtimi i rrugëve ne lagjet Jarine, Asllan Çeshme, Xh.Kada dhe Kristal” shuma prej 25,000.€
- Në projektin 54655 “Rindërtimi i Murit të lumit dhe mveshja e murit me gurë” shuma prej 50,000.€
- Në projektin 52574 “Ndërtimi I Shtatores Dr.Ibrahim Rugova shuma prej 99,000.€

- Në projektin 52732 “Ndërtimi I Shtëpisë Së Fshatit Në Jabllanicë E Vogël Dhe Kosuriq” shuma prej 100,206.50€
- Në projektin 52773 “Ndërtimi I Depos Për Nevoja Komunale shuma prej 7,198.00€
- Në projektin 52756 “Ndërtimi I Strehimores Për Qent Endacak” shuma prej 78,583.21€
- Në projektin 52562 “Hapja Dhe Sanimi I Kanalit Vershues Ne Lagjen Xhemajl Kada” shuma prej 141,242.71€
- Në projektin 54629 “Ndërtimi i sheshit Hotel Korza -Ura e zallit” shuma prej 26,215.88€

Rialokim në programin e Arsimit nga grandit Qeveritarë fondi 10

- Nga projekti 54670 “Rindërtimi i shkollave dhe anekseve në Nabërgjan, Llozhan, Terstenik, Lidhja e Prizrenit, Ramiz Sadiku, Qyshk, Zahaq, Nabërgjan dhe rrethoja e Hil Mosit Jabllanicë” në shumë prej 113,695.00€ rialokohen në:
- Kod projektin 52587 “Ndërtimi i shkollës në Poqeste” në shumë prej 113,695.00€

ZLK Transfer nga fondi 10

- Kod projekti 54637 “Ndërtimi i Deponisë së mbeturinave në Sferkë” 80,000.€ të cilat barten :
- Në projektin 54363 “Ndërtimi i rrugëve në fshatrat Vitomicë, Zllapek dhe Çungur” në shumë prej 80,000.€

Programi i shëndetësisë transfer nga fondi 10

- Kod projekti 54637 “Ndërtimi i Deponisë së mbeturinave në Sferkë” në shumë prej 199,324.47€ të cilat barten :
- Në projektin 53084 “Ndërtimi i qendrës multifunksionale të trajnimeve faza 2 në lagjen 2Korriku” shuma prej 199,324.47€

Programi i shëndetësisë transfer nga fondi 21

- Kod projekti 54637 “Ndërtimi i Deponisë së mbeturinave në Sferkë” në shumë prej 20,675.53€ të cilat barten:
- Në projektin 53084 “Ndërtimi i qendrës multifunksionale të trajnimeve faza 2 në lagjen 2Korriku” shuma prej 20,675.53€

Transfer në shërbime rezidenciale nga fondi 21

- Nga kod projekti 54637 “Ndërtimi i Deponisë së mbeturinave në Sferkë” shuma prej 34,274.76, dhe
- Nga kod projekti 54642 “Rregullimi i Shëtitores prej Urës se Novoselles - Mulliri Berdynajve” shuma prej 100,000.00€,

Mjete nga këto dy kod projekte barten në:

- Kod projektin 53835 “Ndërtimi i strehimorës SHEMF për mbrojtjen e fëmijëve dhe nënave” në shumë prej 134,274.77€.

Me respekt,